

Nje njeri me probleme legastenie me nje inteligjence normale apo te kufizuar e percepton boten e tij ne menyre te diferencuar nga te tjeret, vemendja e tij kur ajo takohet me shkronja apo numra, i percepton ato ndryshe nga njerezit e tjere te cilet nuk kane probleme legastenie. Per kete aresye, ata kane veshtiresi ne te lexuar, shkruar apo llogaritur.

Dr. Astrid Kopp-Duller

Çdokush mund te ndjehet shume mire ne se ka nje mik me legasteni, pasi personat qe kane probleme te tilla, jane shume kreative dhe kane nje perqatitje teknike te larte. Kompjuteri im eshte instaluar komplekt ne rregull, nga femije legastenike dhe ata kane treguar nje durim te madh per te me shpjeguar gjithshka per te.

Nje njeri legastenik karakterizohet nga nje drejtesi e theksuar dhe kjo eshte nje cilesi qe e ka treguar koha dhe per te cilin une ndjehem shume krenar per ta. Nje person legastenik eshte nje mik i vertete per gjithe jeten.

Shpesh legastenia ngaterrohet me veshtiresine apo te meten per te lexuar apo shkruar. Ne fakt ka nje ndryshim para se gjithash per ndihmen qe duhet te jepet ne rastin e legastenise. Le te perpiqemi qe ta analizojme kete ndryshim. Veshtiresite ne te shkruar apo te lexuar mund te kene shkaqe psikike apo fizike, nga metoda e mesimdhienies, defiqitet ne te mesuar apo mungesa e talentit. Perkundrazi legastenia egziston qe ne lindjen e femijes. Po keshtu ky fenomen varet edhe nga mjedisi qe e rrrethon ate. Per kete aresye, ne shkolle, personave legastenike u duhen pershtatur kerkesat dhe ata nuk duhet te perballen me kerkesa apo probleme te veshtira per ta.

Zbulimi i legastenise ne kohen e duhur eshte shume e rendesishme. Shume shenja te saj jepen edhe ne periudhen parashkollore. Faza kur tek femijet zhvillohen shenjat e para te te shkruarit dhe te lexuarit eshte shume e rendesishme. Tek shume femije legastenike shihet se kjo faze eshte shume e gezuashme per ta. Ata shpesh zvarriten ne dysheme duke ecur se prapthi ose anash. Ne keto raste eshte shume e rendesishme qe femija te vrojtohet nese ka shenja te tjera legastenie. Legastenia sipas vezhguesve eshte gjithashtu edhe e trashegueshme nga ana gjenetike, psh. mund te shihet nese nga ana e prinderve apo farefisit ka patur persona legastenike.

Nese pas hyrjes ne shkolle, femija do te kete probleme ne te lexuar, te shkruar apo ne llogaritje, menjehere kjo gje duhet te zbulohet dhe te deklarohet pasi nuk duhet humbur kohe kot. Kalimi i kohes perqitethesit nuk sjell asnjë lloj permiresimi, perkundrazi i sjell mundime si femijes ashtu edhe familjes se tij. Natyrisht kjo gje s'duhet te ndodhe. Ne e dime se legastenia s'eshte semundje dhe femijet legastenike nuk jane femije budallenj.

Une jam trajnere per legasteniket dhe shume femije dhe prinder kerkojne ndihme prej meje. Me ane te nje testi ne kompjuter ose ne menyra te tjera, me ane te lojrave te ndryshme per femijet qe nuk e pelqeje kompjuterin, mundemi te kuptojme cilat jane difektet me te theksuara te shqisave te femijes, te cilat duhet te permiresohen nepermjet trajnitit.

Pjesa e pare e testit ka te beje me aftesine e vemendjes se femijes.

Pjesa e dyte e testit ka te beje me nevojat shqisore te femijes per te lexuar, shkruar dhe llogaritur.

Keto jane :

Diferencat optike – dallimi i objekteve apo shkronjave te ngjashme apo jo te ngjashme dhe ndarja e tyre.

Kujtesa optike – mbajtja mend e objekteve, ngaterrimi apo prishja e tyre dhe kthimi perseri ne gjendjen e meparshme.

Rrjeshtimi optik – paraqitja e objekteve si pershtypje optike ose vendosja e tyre ne rresht ne menyre te rregullt.

Diferencimi akustik – dallimi nepermjet degjimit, ndermjet fjaleve qe degjohen normalisht ose dallimet ndermjet fjaleve me tingellim te ngashem.

Mendimi akustik – frenimi i te degjuarit te nje tingulli akustik, mbajtja mend e tij dhe me pas ridhenia e tij sipas nevojes.

Rrjeshtimi akustik – percaktimi i fjaleve sipas rradhes ne nje pjese, pas degjimit te saj.

Orientimi ne hapesire – percaktimi i kohes, madhesise dhe njesive te tjera matede te hapesires.

Skemat trupore – marrja e nje trupi te caktuar ne shqyrtim, percaktimi dhe dallimi i vendosjes se tij (majtas-djathtas)

Nga nje vleresim i testeve do te percaktohet se cila nga cilesite e mesiperme duhet trajnuar apo stervitur. Ne kete rast flitet per nje legasteni fillestare.

Nese verehen nga ana jone, kufizime te theksuara dhe te perseritura ne te kuptuarit apo te perceptuarit e femijes, atehere kemi te bejme me nje legasteni me te avancuar.

Kjo lloj legastenie eshte me e veshtire se legastenia fillestare per t'u luftuar.

Per kete aresye eshte shume e rendesishme dallimi i menjehershem i shenjave te para te legastenise ne menyre qe femija te ndihmohet menjehere. Femijet legastenike kane nevoje per nderhyrje efektive dhe te sukseseshme. Nuk na duhen perpjekjet e deshperuara te femijeve te cilet nuk kane me besim tek vetja e tyre.

Veçanerisht i rendesishem eshte bashkepunimi ndermjet prinderve, mesuesit dhe trajnerit te femijes legastenik, pasi vetem puna e mesuesit ne klase, nuk mund te perballoje te gjitha problemet e femijes legastenik.

Me kete rast do te doja te nenvizoja se ata mesues te cilet dorezohen para situatave apo rasteve te legastenise, duhet te mendojne mire vazhdimin e punes ne profesionin e tyre.

E rendesishme eshte te sqarohet – Çfare eshte nje gabim ne te shkruar dhe çfare nje gabim ne te perceptuar ?

Femijet legastenike bejne zakonisht gabime ne te perceptuarin e fjaleve pasi ata nuk arrijne te bejne ne momentin e duhur te leximit apo shkrimit, diferencimin shqisor. Gabimet ne te perceptuar ndodhin zakonisht ne fjalet e perdonimit te shpeshte. Ka nje rradhe ne gabimet ne te perceptuar.

Rrjeshtimi i fjales – mungesa e germave(psh. geich), vendosja e germave me teper(psh.geleich), gabim ne rrjeshtimin e germave(psh.gelch).

Ngaterrimi akustik i shkronjave(psh.kleich,walt)

Zgjatimi dhe shkurtimi i fjaleve(psh.schwihmen, küsen, faren)

Verejtja dhe grumbullimi i gabimeve, fjalet te perdonimit te shpeshte shkruhen gabim (vür, wier,fon)

Kombinimet e tipologjive (psh. schmihmen, dlad)

Shkaku i ketyre problemeve tek femijet legastenike, eshte drejtimi i gabuar i vemendjes se tyre gjate procesit te te shkruarit, lexuarit apo llogaritrit. Zgjidhja e ketyre problemeve vjen permes rritjes se vemendjes dhe permiresimit shqisor neprimit trajnimit si nga ana e trajnerit legastenik ashtu dhe nga ana individuale e vete femijes legastenik, ne te lexuar, shkruar apo llogaritur.

Ate objekt qe nje femije legastenik e sheh ne menyre tridimensionale, menjehere ai e fikson.

E rendesishme eshte edhe puna me fjalet qe i perkasin nje familjeje(psh.fahrzeug,fahren) dhe ketu mund te jepen edhe shume fjale te tjera.

Puna me plasteline apo me shkumen e trojes u pelqen shume atyre dhe eshte shume efektive.

Veçanerisht e rendesishme eshte edhe puna ne kompjuter, pune ne te cilin femijet legastenike kane te dhena shume te mira.

Programi i trajnimit duhet te zhvillohet i veçante per çdo femije legastenik.Keta femije kane nevoje per shume vemendje dhe kohe pasi kjo sjell qe ata nje dite te mesojne te shkruajne, lexojne dhe llogarisin njesoj si femijet e tjere. Ne nje shkolle te tille keta femije do te gjejne vetveten dhe nuk do te humbin.

Kontrolli dhe vrojtimi i tyre i vazhdueshem eshte gjithashtu i rendesishem.

Le te perëiqemi se bashku qe te ndertojme nje bote ku legasteniket te kene vendin e tyre.

Le t'i degjojme legasteniket me mire, pasi ata kane shume per te na treguar dhe ne te gjithe kemi shume se ç'te mesojme prej tyre.